



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:045470
Datë: 24.11.2023
Numri i dokumentit: 04968332

C.nr.398/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësit Viva Fresh SH.P.K, me seli në Suhadoll, magjistratja Prishtinë – Lipjan, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Kërveshi & Partners SH.P.K, të cilën e përfaqëson av.Fiton Haklaj, kundër të paditurës Veriu.Info me seli në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.Besim Parduzi, me objekt kontesti: ndalimi i shpifjes dhe kompensimi i dëmit nga shpifja, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 24.11.2023, mori këtë:

AKTGJYKIM


- I. REFUZOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësit Viva Fresh SH.P.K, me të cilën ka kërkuar që vërtetohet se e paditura Veriu.Info SH.P.K, duke shpifur ka publikuar të dhëna të pavërteta për paditësen me të cilat e ka dëmtuar rëndë imazhin dhe reputacionin e paditësit dhe të detyrohet e paditura të ndalë shpifjen drejtuar ndaj paditëses dhe të premtojë se e njëjta nuk do të përsëritet dhe të detyrohet e paditura që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit moral të shkaktuar nga shpifja, t'i paguajë paditëses shumë prej 2,500.00€, me kamatë vjetore prej 8%, **si e pa bazuar.**
- II. OBLIGOHET** paditësi që t'ia paguaj shpenzimet procedurale të paditurës dhe atë në lartësi prej 478.40€, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë

Arsyetim


1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi me datën 21.04.2020 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, me të cilën ka kërkuar që vërtetohet se e paditura Veriu.Info SH.P.K, duke shpifur ka publikuar të dhëna të pavërteta për paditësen me të cilat e ka dëmtuar rëndë imazhin dhe reputacionin e paditësit dhe të detyrohet e paditura të ndalë shpifjen drejtuar ndaj paditëses dhe të premtojë se e njëjta nuk do të përsëritet dhe të detyrohet e paditura që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit moral të shkaktuar nga shpifja, t'i paguajë paditëses shumë prej 2,500.00€, ndërsa në emër të dëmit material shumë prej 2,500.00€, me kamatë vjetore prej 8%, të cilat do të precizohen në shumë e saktë pas pranimit të ekspertizave. Mirëpo, në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësi është tërhequr nga padia sa i përket kërkesës për kompensimin e dëmit material, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë ka mbetur e pa ndryshuar.

I autorizuari i paditëses në fjalën përfundimtare deklaroj nga deklaratimet e palëve në procedurë nuk mbeti kontestuese fakti që e paditura ka shpërndarë lajmin në artikullin "Dëshmi të reja nga



shkeljet që iu bëhen punëtorëve nga Kompania Viva Fresh”, fakt ky i cili u vërtetua edhe me artikullin e datës 04.04.2020, provë kjo bashkangjitur në padi, me provën kërkesë për përmirësimin e shpifjes del se pala paditëse i është drejtuar organit kompetent për përmirësimin e shpifjes, ku ky organ këtë kërkesë e ka trajtuar si ankesë dhe të njëjtën me vendimin e datës 13.10.2020 e ka refuzuar si të pabazuar. Paditësja ka pretendime që si nga titulli edhe nga përmbajtja e të njëjtit tregohen fakte të pavërteta duke nisur nga raportimet për skandalet në kompaninë Viva Fresh në redaksinë e Gazetës Infokus kanë arritur shumë ankesa nga punëtorët e kësaj kompanie, kështu duke sjell edhe dëshmi për shkelje, ku oraret shtesë nuk paguhen si dhe ditët e humbura nuk paguhen dhe se këto janë ankesat që janë dërguar nga punëtorët e kësaj kompanie, teksa shihet që udhëzimet për orare të punës janë rritur nga 8 orë punë në 10 orë, sipas personave që kanë treguar për këto shkelje thuhet se orët shtesë nuk paguhen te e paditura, në provat e administruara dhe dëshmitë që përmbajnë të njëjtat shihet që është një komunikim në viber ku fshihen të dhënat dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si të besueshme me çka e paditura nuk ka vërtetuar identitetin e tyre sikurse do të duhej në mënyrë të njëjtë të vërtetohej edhe saktësia e asaj se çfarë ata pretendojnë si dhe kontrollimin e asaj përmbajtje me rastin e publikimit, veprim këto të cilat e paditura nuk iu është përmbajtur dhe ka dëmtuar dhe denigruar reputacionin me emrin e njëjtë të paditëses me çka i ka shkaktuar dëm jo material. Nga deklaratimet e palëve në procedurë si verbalisht ashtu edhe përmes parashtrësive kontestuese paraqitej fakti nëse artikulli përmban shpifje, përgjegjësia e të paditurës për shpifje dhe fakti nëse paditësja i ka shterur mjetet juridike të përcaktuar me Ligjin Civil kundër shpifjes dhe fyerjes. Sa i përket asaj se artikulli përmban shpifje paditësja pretendon që në kuptim të definicionit neni 3 pika a e cila përkufizon shpifjen artikulli i tillë në përmbajtje përmbush të gjitha elementet e një shpifje. Sa i përket përgjegjësisë së të paditurës për shpifje përgjegjësia e saj del nga neni 3 pika c) lidhur me nenin 5 paragrafi 1, ku paragrafi 1 i nenit 5 përveç kryerjes së shpifjes si përgjegjës mban edhe përhapjen e shpifjes, kurse në paragrafin 2 të nenit 5 janë paraparë subjektet përgjegjëse për shpifje përmes subjekteve mediale. E paditura në seancën përgatitore është thirrur në atë se ka mungesë në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes se ka mungesë të përgjegjësisë duke deklaruar se vetëm ka cituar dhe publikuar lajmin e gazetës tjetër Gazetës Infokus, neni 11 paragrafi 1 përjashton përgjegjësin e personave të tjerë të cilët nuk janë autor, redaktor ose publikues nëse plotësohen dy elemente në mënyrë kumulative e që janë a) ai/ajo nuk kishte dijeni dhe b) nuk ekziston arsyeja të besohet se ai /ajo kontribuon në përhapjen e shpifjes ose fyerjes. E paditura duke qenë vetëm publikuese nuk i ka përmbushur këto dy kushte të lirohet nga përgjegjësia duke përhapur kështu lajme të pavërteta e njëjta duhet të mbajë përgjegjësi. Në rastin konkret nga artikulli dhe përmbajtja e të njëjtit duke pasur parasysh fshehjen e identitetit dhe mos kontrollimin e asaj çka pretendohet për shkeljen e të drejtave të punëtorëve ka qenë në dijeni dhe ka arsye të besohet se ka kontribuar në përhapjen e shpifjes. Sa i përket shterjes së mjeteve për zvogëlimin e dëmit tani më është vërtetuar se e paditura ka ndërmarrë hapat ligjor për zvogëlimin e dëmit dhe i është refuzuar ankesa në këtë drejtim. Detyrimi i kompensimit bashkë me vëllimin e shpërblimit të saj dalin nga neni 9 i LMD-së, neni 136 lidhur me nenin 140 të LMD-së, kurse vëllimi i shpërblimit të saj nga neni 14 i LCKSHF lidhu me nenin 182 dhe 187 të LMD-së, ku neni 182 parasheh format e shpërblimit të dëmit jomaterial dhe mënyrat e shpërblimit të saj nga gjykata si dhe neni 187 e cila parasheh shpërblimin për personat juridik në rast të denigrimit të emrit të mirë pavarësisht shpërblimit të dëmit material ose qoftë se edhe nuk ka dëm material. Duke u bazuar në këto i propozojmë gjykatës që të marrë vendim si në petitumin e padisë për kompensimin e dëmit jomaterial të shkaktuar nga shpifja në lartësinë si në përmbajtjen e saj me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë konkretisht për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, shpenzimet për taksë 30 euro, parashtrësë për çaktimin e detyrave të ekspertit shumë prej 104 euro, shpenzimet për dy seanca për secilën në vlerë prej 135.20 euro të cilat në total kapin vlerën 508.40 euro.



I autorizuari i të paditurës në fjalën përfundimtare deklaroj se mbesim në tërësi si në deklaratimet e mëhershme dhe kërkojmë nga gjykata që këtë padi ta refuzoj si të pabazuar vërtetuar në faktin se asnjë nga pretendimet e paditëses nuk janë vërtetuar në këtë procedurë dhe se të gjitha provat e sjellura nga paditësja e vërtetojnë të kundërtën e asaj që deklaron. Fillimisht liria e shprehjes dhe ndalimi i censurës janë kategori kushtetuese, ka edhe praktikë të GJEDNJ-së ku është vërtetuar se shpërndarja e lajmit për arsye të interesit publik nuk mund të konsiderohet si shpifje. Gjithashtu vlen të theksohet edhe njëherë që Gazeta Veriu. Info nuk është autore e lajmit dhe se vetëm e ka shpërndarë lajmin e Gazetës Infokusi dhe se ndaj Gazetës Infokusi si autore nuk është paraqitur padi ose ankesë në Këshillin për Media dhe nuk ka padi në gjykatë ndaj tyre dhe ne konsiderojmë se e tëra kjo procedurë është një taktikë e kompanive të mëdha të cilat dëshirojnë t'i frikësojnë mediat që në të ardhmen të mos shkruajnë ndaj tyre, sikur të ishte i vërtet fakti se ky shkrim është shpifje Kompania Viva Fresh Shpk do të shkonte ta ndiqte burimin e shkrimit e jo shpërndarësin e tij. Gjithashtu, Këshilli i Mediave të shkruara të Kosovës e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Kompanisë Viva Fresh shpk dhe ku është vërtetuar se nuk ka shkelje sepse ankuesi nuk ka paraqitur asnjë fakt se publikimi i këtij artikulli i ka shkaktuar dëm palës ankuese. Gjithashtu pala paditëse thirret në shkelje se është shkelur ligji sepse është fshehur identiteti i personit i cili kontakton me Gazetën Infokus, kjo fshehje është bërë nga autori Gazeta Infokus i cili ka të drejtë ta mbroj burimin e tij të informacionit edhe pse kjo është bërë nga një palë tjetër, kompania Viva Fresh ndjehet e dëmtuar nga Gazeta Veriu.info për një artikull të publikuar nga pala e tretë. Bazuar në të gjitha këto dhe deklaratimet e mëhershme si dhe provat e administruara nga kjo gjykatë kërkojmë që kjo padi të refuzohet, gjithashtu i kërkojmë shpenzimet e procedurës në shumën prej 478.40 euro dhe atë për përgjigje në padi dhe për dy seanca sipas tarifës së avokatëve për vlerën e padisë mbi 1000 euro.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: kërkesa për përmirësimin e shpifjes e datës 05.04.2020, vendimi i datës 13.10.2020 i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Artikulli i datës 04.04.2020 në kopje fizike.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadija e paditësit është **e pa bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e kërkesës për përmirësimin e shpifjes e datës 05.04.2020, gjykata vërtetojë faktin se paditësja Viva Fresh SH.P.K, ka paraqitur kërkesë për përmirësimin e shpifjes pranë Komisionit të Pavarur për Media dhe Veriu.Info SH.P.K, lidhur me artikullin me titull “Dëshmi të reja për shkeljet që ju bëhen punëtorëve nga kompania Viva Fresh(FOTO)” dhe ka kërkuar që zbrapsjen e deklaratave të publikuara në lidhje me Viva Fresh SH.P.K, ashtu që të përmirësohet shpifja duke tërhequr përmbajtjen e këtij artikulli dhe në atë mënyrë që kjo zbrapje të ketë po të njëjtën vëmendje sikurse edhe deklaratat që përbëjnë shpifje ndaj Viva Fresh SH.P.K.

Me leximin e vendimit të datës 13.10.2020 i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, gjykata vërtetojë faktin se Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës nuk e ka miratuar ankesën e paditëses Viva Fresh SH.P.K lidhur me artikullin “Dëshmi të reja për shkeljet që ju bëhen punëtorëve nga kompania Viva Fresh (FOTO)” të publikuar nga Veriu.Info.



Me leximin e artikullit të datës 04.04.2020 në kopje fizike, gjykata vërtetoi faktin se e paditura Veriu.Info me datën 04.04.2020 ka publikuar artikullin me titull “Dëshmi të reja për shkeljet që ju bëhen punëtorëve nga kompania Viva Fresh (FOTO)”.

4. Ligji i aplikueshëm

Në bazë të nenit 3 pika a) e Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (LCKSHF), parashihet që *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.”*

Në bazë të nenit 5 paragrafi 2 i LCKSHF-së, parashihet që *“Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj.”*

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 i LCKSHF-së, parashihet që *“Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë për të cilën ai ose ajo nuk kanë qenë autor, redaktor ose botues dhe ai ose ajo nuk kishte dijeni, dhe nuk ekziston arsye të besohet, se ai ose ajo kontribuan në përhapjen e shpifjes dhe fyerjes.”*

Në bazë të nenit 12 të LCKSHF-së, parashihet që *“Para parashtrimit të një padie sipas këtij Ligji, një person që pretendohet të jetë i dëmtuar do të ndërmerret të gjitha masat e arsyeshme për të zbutur çdo dëm të shkaktuar nga shprehja. Në veçanti, paditësi do të kërkojë përmirësimin e asaj shprehje nga personi i cili pretendohet të ketë shkaktuar dëmin. Veprimet e tilla mund të përfshijnë kërkesën e përmirësimit të shprehjes së supozuar shpifëse apo fyese nga publikuesi dhe paraqitjen e kërkesës para organit kompetent rregullativ sikurse (Komisioni i Pavarur për Media) ose Organi vetërregullativ sikurse (Këshilli për Mediat e Shtypura).”*

Në bazë të nenit 42 paragrafi 1 i Kushtetutës së Kosovës, parashihet që *“Garantohet liria dhe pluralizmi i medieeve.”*, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parasheh që *“Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieeve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”*

Në bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashihet që *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.”*

5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka arritur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar**.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se e paditura Veriu.Info me datën 04.04.2020 ka publikuar artikullin “Dëshmi të reja për shkeljet që ju bëhen punëtorëve nga kompania Viva Fresh (FOTO)”.



Kontestuese ishte vetëm fakti se me publikimin e këtij artikulli, a ka bërë shpifje dhe fyerje e paditura Veriu.Info ndaj paditëses Viva Fresh SH.P.K.

Gjykata konstaton se e paditura Veriu.Info me rastin e publikimit të artikullit “Dëshmi të reja për shkeljet që ju bëhen punëtorëve nga kompania Viva Fresh (FOTO)”, nuk ka bërë shpifje dhe fyerje ndaj paditëses Viva Fresh SH.P.K, pasi që me këtë rast nuk plotësohen kushte ligjore të parapara me nenin 3 pika a) e LCKSHF-së i cili parasheh se çka përbën shpifje, përkatësisht parasheh se *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklaratë të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklaratat është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.”*, andaj në këtë rast duke pasur parasysh se artikulli i publikuar me titullin “Dëshmi të reja për shkeljet që ju bëhen punëtorëve nga kompania Viva Fresh (FOTO)” është marrë nga një portal tjetër, përkatësisht nga portali – gazeta “Infokus”(fakt ky i cili nuk është i kontestueshëm nga palët ndërgjyqëse dhe i njëjti vërtetohet me leximin e artikullit), e paditura Viva Fresh edhe sikur ky lajm të ishte i pavërtetë, nuk ka mundur ta dijë një gjë të tillë sepse e njëjta nuk ka qenë autore e këtij lajmi dhe as burimi i informacionit nuk ka qenë i të paditurës, por i gazetës “Infokus”, andaj kushti ligjore sipas nenit 3 pika a) e LCKSHF-së, është që përveç se publikimi i një fakti duhet të jetë i pavërtetë, publikuesi duhet ta dijë ose është dashur ta dijë se fakti apo deklaratat është e pavërtetë, por që në rastin konkret, duke marrë parasysh se autore dhe publikuese e këtij artikulli ka qenë një gazetë tjetër e paditura nuk ka mundur t’i dijë këto rrethana, duke i shtuar këtu edhe faktin se burimi i informacionit për mediat e shkruar është konfidencial dhe i mbrojtur edhe sipas ligjit pozitiv në Republikën e Kosovës.

Gjykata konstaton se padia e paditësit është e pabazuar edhe për faktin se e paditura nuk ka qenë autore, redaktore apo botuese e lajmit – artikullit “Dëshmi të reja për shkeljet që ju bëhen punëtorëve nga kompania Viva Fresh (FOTO)”, por botuese ka qenë gazeta “Infokus”, këtë fakt, përveç që e paditura e ka cituar në artikullin e publikuar, këtë gjë nuk e konteston as paditësja. Andaj në bazë të nenit 11 paragrafi 1 i LCKSHF-së, i cili parasheh që *“Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë për të cilën ai ose ajo nuk kanë qenë autor, redaktor ose botues dhe ai ose ajo nuk kishte dijeni, dhe nuk ekziston arsye të besohet, se ai ose ajo kontribuan në përhapjen e shpifjes dhe fyerjes.”*, gjykata konstaton se nuk mund të mbahet përgjegjëse e paditura për një artikull për të cilin një gazetë tjetër ka qenë botuese dhe autore.

Gjykata konstaton se paditësja nuk ka përmbushur as detyrimin për të zbutur dëmin të cilën e parasheh nenit 12 i LCKSHF-së, sepse paditësja nuk i ka paraqitur kërkesë të paditurës për të përmirësuar e shpifjes siç kërkohet nga kjo dispozitë. Paditësja me kërkesën për përmirësimin e shpifjes e datës 05.04.2020, ka kërkuar nga Komisionit të Pavarur për Media që të përmirësohet shpifja duke tërhequr përmbajtjen e këtij artikulli dhe në atë mënyrë që kjo zbrapje të ketë po të njëjtën vëmendje sikurse edhe deklaratat që përbëjnë shpifje ndaj Viva Fresh SH.P.K, dhe për këtë kërkesë e njëjta e ka marrë përgjigjen se e paditura nuk ka bërë asnjë shkelje me rastin e publikimit të artikullit kontestues. Mirëpo një kërkesë të tillë, paditësja nuk i’a ka dërguar edhe të paditurës dhe kjo vërtetohet edhe nga libri i pranimit të cilën paditësja i’a ka bashkangjitur kërkesës së datës 05.04.2020, ku shihet se këtë kërkesë e ka pranuar vetëm Komisioni i Pavarur për Media, por jo edhe e paditura Veriu.Info.

Gjykata, thekson se shtypi i lirë dhe i pavarur është esencial për shoqërinë, kjo nënkupton që shtypi duhet të jetë i lirë edhe nga presioni privat. Çdo kush ka të drejtën e shprehjes, kjo e drejtë përfshinë lirinë të mbaj opinionione dhe të jap informacione përmes medias. E paditura thekson sa i përket mesazheve të publikuara se është komunikim në viber ku fshihen të dhënat dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen si të besueshme me çka e paditura nuk ka vërtetuar identitetin e tyre,

mirëpo gjykata thekson se e drejta e gazetarëve të mbajë burimin e informatës sekret dhe të mos i publikojë të dhënat është një e drejtë esenciale që t'i inkurajojnë personat që të flasin lirshëm.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJEDNJ), në rastin Doodwin v United Kingdom (1996), ka theksuar se interesi i kompanisë private për të ndjekur burimin e informacionit nuk ishte i mjaftueshëm për të peshuar më shumë se interesi i publikut për të mbrojtur të drejtën e gazetarëve për të ruajtur burimet konfidenciale. Mbrojtja e burimeve të informacionit është një kusht themelor për lirinë e shtypit, pa një mbrojtje të tillë, burimet e informacionit mund të pengohen të ndihmojnë shtypin në informimin e publikut për çështjet me interes publik.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJEDNJ), në rastin Thoma v Luxemburg, ka theksuar se “gazetarët nuk duhet që në mënyrë automatike të konsiderohen përgjegjëse për përsëritjen e lajmeve potencialisht shpifëse të publikuara nga të tjerët”, ashtu siç kemi të bëjmë edhe në këtë çështje ku e paditura ka shpërndarë një lajmë të publikuar nga dikush tjetër.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marr komfor nenit 449 dhe 452 paragrafi 1 i LPK-së, ashtu që paditësit ka obligim t'ia kompensoj të paditurit shpenzimet në lartësi prej 478.40€ dhe atë për përgjigje në padi dhe për dy seanca sipas tarifës së avokatëve për vlerën e padisë mbi 1000 euro.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.398/2020, datë 24.11.2023



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.